




Progres i rekomandimeve të Këshillit të Investimeve

JANAR- GUSHT 2022

ECURIA E REKOMANDIMEVE TË KI EVIDENTUAR NË PERIUDHËN JANAR - GUSHT 2022

Statusi i rekomandimeve të KI, Gusht 2022




- ✓ 27 mbledhje të realizuara nga Këshilli I Investimeve
- ✓ 284 rekomandime në total
- ✓ Rekomandimet e plotësuara zënë 45.4% të totalit
- ✓ Rekomandimet në proces rreth 16.2%.
- ✓ Në krahasim me fundvitin e 2021, gjatë periudhës Janar – Gusht 2022 evidentohet rënie me 6.1 % e rekomandimeve të paplotësuara, nga 44.5% në 38.4 % aktualisht.

*Plotësisht (80-100%) ose pjesërisht (50-70%)

Ecuria e rekomandimeve të KI evidentuar në periudhën Janar - Gusht 2022

Progresi i rekomandimeve, Gusht 2022



Progres pozitiv në 33 rekomandime:

- 19 të zbatuara*
- 14 në proces zbatimi.

- ✓ 13 rekomandime nga ato të adresuara Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ndër vite, u raportuan me progres (7 në proces dhe 6 të përmbushura).
- ✓ 6 nga rekomandimet me progres, janë raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave.
- ✓ Nga fokusi i shtuar i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në drejtim të prioritizimit të rekomandimeve të KI, 5 rekomandime morën reagim nga insitucionet përgjegjëse.
- ✓ AZHT është një tjetër institucion i cili raportoi 4 rekomandime me progres gjatë kësaj periudhe.

Ecuria e rekomandimeve të KI evidentuar në periudhën Janar - Gusht 2022

PËRMIRËSIME LIGJORE NË DREJTIM TË :

-INOVACIONIT NË SIPËRMARRJE

-NXITJES SË INVESTIMEVE NË AGRO-PËRPUNIM

*Miratimit të pjesës më të madhe të
legjislacionit sekondar në lidhje me zbatimin
e Ligjit Nr. 55/2020, datë 30.04.2020 "Për
Shërbimet e Pagesave"- miratuar gjatë
Janar-Mars 2022 rreth 90% e akteve
nënligjore.*

*Miratimi i projektligjit "Për Mbrojtjen dhe
Zhvillimin e Start-up Inovative"*

Në vijim të këtij procesi, është mjaft e
rëndësishme të miratohet edhe
legjislacioni sekondar i lidhur më këtë ligj

*Ndryshime dhe harmonizim i ligjit nr.
106/2016 "Për prodhimin biologjik, etiketimin e
produkteve biologjike dhe kontrollin e
tyre" me dispozitat e Rregullores së BE
2018/848 "Për prodhimin organik"*

Ecuria e rekomandimeve të KI evidentuar në periudhën Janar - Gusht 2022

PËRMIRËSIM I MËTEJSHËM I FUKSIONALITETEVE TË PLATFORMËS E-LEJE

Finalizimi i punës për përgatitjen e një manuali të detajuar operacional, teknik dhe ligjor në formën e një udhëzimi për të gjithë përdoruesit, përfshirë Bashkitë dhe AIDA si institucione të cilat promovojnë shërbimet me një ndalesë të platformës tek investitorët potencialë.

Konfirmimi i përfundimit të ndryshimeve ligjore të rekomanduara në vitin 2018 referuar ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" që është shfuqizuar tashmë dhe miratuar Ligji 111/2018 "Për kadastrën"- Bazuar në ligjin nr.8402/1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" (i ndryshuar) janë bërë ndryshimet e fundit me Ligjin Nr. 120/2020 dhe IKTK dhe KKTMK janë pjesë e institucioneve në sistemin e leje, si dhe çdo institucion tjetër

Trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore të cilat janë të përfshira direkt në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit nëpërmjet platformës e-Leje. Specifikisht vëmendje i është kushtuar këtij procesi, nga Drejtoria e NJQV-së, e cila është ngritur pikërisht për asistencë e trajnim ndaj NJQV-ve.

Ecuria e rekomandimeve të KI evidentuar në periudhën Janar - Gusht 2022

Thjeshtimi i mëtejshëm i procedurave të rimbursimit të TVSH-së

Mbështetje për sektorin e bujqësisë në drejtim të formalizimit, standartizimit dhe Investimeve

Që nga dt. 7 mars 2022 çdo kërkesë për rimbursimin e TVSH-së bëhet vetëm online, përmes Platformës Dixhitale të Rimbursimit të TVSH-së.

Rregullorja e drejtorisë së Rimbursimit ka pësuar ndryshime të miratuara në fund të 2021 që lehtësojnë më tej procesin e rimbursimit dhe filtrat e riskut për disa kategori.

Mbështetje e traqetur dhe më e fokusuar në standartizimin dhe rritjen e eksporteve të produkteve bujqësore rritje e mbështetjes nëpërmjet skemave mbështetëse direkte, për implementimin dhe certifikimin Global GAP dhe të bujqësisë organike kryesisht në sektorët e prodhimit të perimeve, frutave, rrush, ullinj dhe agrume

Marrveshje e nenshkruar mbi një projekt prej 1.84 milion € për të forcuar cilësinë dhe përputhjen e standardeve të produkteve Shqiptare


Përmirësim i nivelit të formalizimit të bizneseve që operojnë në sektorin e bujqësisë
Aktualisht, numri i fermerëve të formalizuar, pajisur me NIPT Fermeri është rreth 82 mijë.

Në fillim të 2022 ishin rreth 19,225 fermerë të pajisur me kartë elektronike.

Mundësim i aksesit të investorëve potencialë në një inventar të pronave publike bujqësore MBZHR tashmë ka inventarizuar / evidentuar sipërfaqen e tokave bujqësore në administrim të saj me destinacion qiradhënien, por ky inventar nuk është bërë akoma publik.

REKOMANDIMET E PAPËRMBUSHURA

Rekomandimet e pa zbatuara sipas Temës %, Gusht 2022



Janë aktualisht 109 rekomandime të paplotësuara

Ndër institucionet që zënë peshën më të madhe në zbatim të rekomandimeve të papërmbyshura janë:

- ✓ **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit – 14 rekomandime**
- ✓ **Agjencia Shtetërore e Kadastrës – 16 rekomandime**